

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.10383, DATË 24.2.2011 “PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj propozohet në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, dhe synon rregullimin e deklarimit të pagës për efekt të kontributit shëndetësor për tatimpaguesit që ushtrojnë aktivitet ekonomik si profesionist të lirë. Ndryshim tjetër i rëndësishëm me këtë projektligj lidhet edhe me përcaktimin nga Këshilli i Ministrave të detyrimit të pagesës së kontributeve për punonjësit e papaguar të familjes. Synimi i dhënies së këtij diskrecioni Këshillit të Ministrave lidhet me përcaktimin e rasteve kur është dhe kur nuk është i detyrueshëm sigurimi i personave të papaguar të familjes. Kjo për arsye se në bazë të ligjit të procedurave tatimore, në rast konstatimi të mospagesës së kontributeve nga kjo kategori, zbatohen penalitetet e ligjit. Për këtë arsye, hiqet ky detyrim ligjor i pagesës së kontributeve për këtë kategori dhe lihet në vullnetin e tyre për derdhjen e kontributeve.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektakti nuk është i parashikuar në programin analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, gjatë 4-mujorit të tretë të vitit 2015.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKT-LIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Miratimi i këtij projektligji do të sjellë një ndryshim të rëndësishëm për sa i përket mbledhjes së kontributeve të sigurimeve shëndetësore për subjektet që ushtrojnë

aktivitet, si profesionistë të lirë, siç mund të jenë: avokatët, noterët, mjekët, kontabilistët, stomatologët, arkitektët etj.

Një i vetëpunësuar paguan kontribute për sigurimin shëndetësor bazuar në dyfishin e pagës minimale që është 44 000 lekë. Ndërkohë nëse ky individ do të ishte i punësuar në një subjekt tjetër tatimor do të paguante kontribut në bazë të pagës bruto të deklaruar. Ky trajtim i diferencuar krijon shtrembërim në kontribute mes një të vetëpunësuari dhe një të punësuari që merr një pagë të caktuar për ushtrimin e profesionit si i punësuar në një subjekt tatimor.

Me anë të këtij propozimi synohet që të arrihet eliminimi i shtrembërimeve në trajtimin e pagesës së kontributit shëndetësor, për të vetëpunësuarit, profesionistë të lirë. Ky projektligj shoqërohet edhe me ndryshimin në ligjin për sigurimet shoqërore, ku ndryshimi është bërë në të njëjtën linjë me sigurimet shëndetësore.

Duke iu referuar përkufizimit në aktet ligjore e nënligjore të termit “i vetëpunësuar” kuptimi është referenca tek një individ, i cili gjen vet hapësira të vetëpunësimit nëpërmjet sipërmarrjes së vet dhe iniciativës së vet ekonomike.

Pikërisht për këtë arsye, në sistemin fiskal “i vetëpunësuari” ka një trajtim ndryshe për efekt të pagimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Qëllimi ligjor për caktimin e detyrimit të pagesës së kontributeve, qoftë edhe minimale, lidhet me detyrimin e sigurimit të përfitimeve minimale për pension dhe akses në kujdesin shëndetësor shtetëror.

Tabela e mëposhtme jep diferencat midis bazës dhe normës së taksimit të një të punësuari dhe një të vetëpunësuari.

Kategoria	Norma %			
	i punësuar/punonjës	Baza	Dysheme	Tavan
<i>I punësuar</i>				
Kontributet shoqërore	9.5/15.0	Paga bruto	22000 LEK	97030 LEK
Kontributet shëndetësore	1.7/1.7	Paga bruto	jo	jo
<i>I vetëpunësuar</i>				
Kontributet shoqërore	23	Paga minimale	jo	Jo

Kontributet shëndetësore	3.4	Dy paga minimale	jo	jo
--------------------------	-----	------------------	----	----

Në kategorinë e të vetëpunësuarit, sipas përkufizimit ekzistues, përfshihen edhe tatimpaguesit të cilët ofrojnë shërbime, si profesionistë të lirë, të tillë si: noter, doktor, farmacist, avokat, inxhinier, vlerësues pasurish etj., të cilët gëzojnë të njëjtin trajtim fiskal, megjithëse me të ardhura më të larta, sikurse një i vetëpunësuar në sektorin e tregtisë, zejtarisë etj.

Nëse do të krahasojmë një të punësuar në një kompani X që merr një pagë prej 100 mijë lekësh në muaj dhe një avokat rezulton se me normat në fuqi, baza e llogaritjes së kontributeve është, si më poshtë vijon:

Kontribute	I punësuar	Avokat
Kontribute shoqërore	23,772	5,060
Kontribute shëndetësore	3,400	1,496
Total	27,172	6,556

Pra, një avokat paguan 6 556 lekë në muaj kontribute, ndërsa i punësuar paguan 27 172 mijë lekë në muaj.

Ndryshim tjetër i rëndësishëm në këtë projektligj lidhet edhe me heqjen e një barre të detyrueshme financiare për pagesën e kontributeve nga personat e papaguar të familjes. Kjo për arsye se në bazë të ligjit të procedurave tatimore, në rast konstatimi të mospagesës së kontributeve nga kjo kategori, zbatohen penalitete të ligjit. Për këtë arsye, hiqet ky detyrim ligjor i pagesës së kontributeve për këtë kategori dhe lihet në vullnetin e tyre për derdhjen e kontributeve. Kjo do të bëhet sipas përcaktimit të Këshillit të Ministrave.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në nenet 1 dhe 2 parashikohet që të bëhen disa shtesa dhe konkretisht propozohet që pas fjalëve "... punonjësit e papaguar të familjes ..." shtohen "... për tatimpaguesit e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave ...".

Në nenin 3 parashikohet se baza për llogaritjen e kontributit për të vetëpunësuarit që ofrojnë shërbime në veprimtari ekonomike, si profesione të lira, është paga maksimale e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Për këtë arsye, është bërë ndërhyrja në nenin 7, të ligjit në fuqi, duke shtuar paragrafin:

“Për kategori të veçanta personash, të cilët kryejnë veprimtari ekonomike profesionale, përfshirë edhe punonjësit e papaguar të familjes që punojnë e bashkëjetojnë me të vetëpunësuarin, profesionet, paga për efekt të llogaritjes të kontributeve si dhe kriteret e përcaktimit të saj, caktohen nga Këshilli i Ministrave.”.

Paga maksimale për efekt të kontributeve të sigurimit shëndetësor përcaktohet në vendimin nr.77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, i ndryshuar

Aktualisht, për të vetëpunësuarit përfshirë edhe profesionet e lira, paga mujore për efekt të sigurimit të llogaritjes së kontributit të sigurimit të kujdesit shëndetësor është sa dyfishi i pagës minimale, e barabartë me 44 000 (dyzet e katër mijë) lekë. Masa e kontributit është 3.4% e kësaj page e cila shkon në vlerën 1 496 lekë.

Ky projektligj synon ndryshimin e pagës për efekt të llogaritjes së sigurimeve shëndetësore, e cila propozohet të jetë paga maksimale për efekt të pagesës së kontributeve që është e njëjta pagë maksimale e cila aplikohet edhe për përllogaritjen e detyrimit për kontributin shoqëror. Kontributi që do të paguhet do të jetë në masën 3 299 lekë.

Këshilli i Ministrave do të përcaktojë listën e profesioneve të lira.

Kjo masë në finale është në përfitim të vetë të vetpunësuarit, për arsye se duke kontribuar sot më shumë në skemën e kontributeve, përfiton më shumë pension në të ardhmen dhe kontribuon në sistemin shëndetësor.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ AKTI

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Financave.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj shoqërohet me efekte financiare pozitive, në masën rreth 100 milionë lekë.

KËSHILLI I MINISTRAVE